



VENDIMI I PAPRANUESHMËRISË

Data e miratimit: 1 mars 2016

Lënda nr. 2015-10

Shaban Syla

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 29 shkurt 2016, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Paul LANDERS, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar me 28 korrik 2015.

II. FAKTET

2. Faktet e ankesës të parashtuara nga ankuesi mund të përmbliidhen si në vijim:

3. Me 28 dhjetor 2009, Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës ka nxjerrë një vendim mbi vazhdimin e hetimit i cili ishte iniciuar më 30 nëntor 2009. Aktvendimi për vazhdim ishte me qëllim të përfshirjes së ankuesit në hetim si i dyshuar.
4. Me 21 qershor 2011, Zyra e Prokurorisë Speciale ka paraqitur një kërkesë në Gjykatën Themelore për arrestimin e ankuesit dhe ishte lëshuar një urdhër arrest.
5. Me 6 korrik 2011, Zyra e Prokurorisë Speciale ka paraqitur një kërkesë në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës për paraburgosjen e ankuesin. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Gjykata e Qarkut. Megjithatë janë shqiptuar masa të tjera si raportimi në Stacionin e Policisë dhe ndalesa për t'ju afruar të pandehurve të tjerë ose palës së dëmtuar.
6. Me 28 korrik 2011, një panel prej tre gjykatësve kanë modifikuar Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut të datës 6 korrik 2011 dhe, si rrjedhojë ankuesi ishte vendosur në arrest shtëpiak.
7. Me 17 dhjetor 2012, ankuesi ishte dënuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës për tentim vrasje të rëndë. Ai ishte dënuar me burgim prej tetë vitesh. Sipas dokumenteve të ofruara, ankuesi ka qenë në arrest shtëpiak nga 28 korrik 2011 deri në dënimin e tij. Pas dënimit të tij, ankuesi u ndalua përsëri në arrest shtëpiak. Ankuesi ka paraqitur ankesë ndaj aktvendimit të Gjykatës së shkallës së parë (me 25 mars 2013). Në një aktvendim të datës 24 maj 2013, Gjykata Themelore e Prishtinës ka urdhëruar vazhdimin e arrestit shtëpiak ndaj ankuesit.
8. Gjykata e Apelit ka trajtuar ankesën e ankuesit me 12 dhjetor 2013. Në aktgjykimin e tij të datës 21 shkurt 2014, Gjykata e Apelit ka gjetur ... *“se ka pasur shkelje të ligjit penal në kuptimin që koha e kaluar nga të pandehurit në paraburgim nuk ishte llogaritur në dënim”*. Gjykata e Apelit e ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të datës 17 dhjetor 2012 dhe konstaton se në dënimet e shqiptuara ndaj ankuesit duhej të përfshinin edhe kohën e kaluar në paraburgim deri në dënimin me burgim të shkallës së parë dhe zgjedhjen e ankesave.

III. ANKESAT

9. Ankuesi ka pohuar se ka qenë në arrest shtëpiak nga data 6 maj 2011 deri me 23 mars 2015 dhe se të drejtat e tij themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës janë shkelur. Ankesa e tij duket se ka të bëjë me çështjen e zbritjes së periudhës kohore të cilën ai e ka kaluar në arrest shtëpiak nga dënimi i tij. Ankuesi nuk ka artikuluar plotësisht rrethanat nën të cilat kjo është thënë të ketë ndodhur. Nga parashtrirat e ankuesit mund të thuhet se ankuesi pretendon se ka shkelje të neneve 5 dhe 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa):

IV. LIGJI

10. Si një çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të zbatuar instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të jenë të garantuar nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
11. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
12. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, të Rregullores së Punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat lidhur me shkeljet e pretenduara të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave.
13. Përderisa natyra e saktë e ankesës është disi e paqartë, Paneli e kupton ankesën se drejtohet kundër vendimit/vendimeve të gjykatave të Kosovës në lidhje me ndalimin e tij.
14. Paneli në shumë raste ka konstatuar se, sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së punës, bazuar në konceptin e llogaridhënies së OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë, në parim nuk ka kompetencë as mbi aspektet administrative e as mbi aspektet juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih ndër të tjera Halili kundër EULEX-it, nr. 2012-08, 15 janar 2013, par. 21; Pajaziti kundër EULEX-it, nr. 2012-05, 4 tetor 2012 par. 9-10; Dobruna kundër EULEX-it, nr. 2012-03, 4 tetor 2012, par. 12).
15. Nga vetëm ky fakt rezulton se ankesa del jashtë kuadrit të mandatit të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë. Paneli nuk është i bindur se ankuesi ka treguar që sjellja për të cilën është ankuar mund t'i atribuohet ndryshe Misionit.
16. Për më tepër, Paneli vëren se sjellja për të cilën është ankuar bie jashtë afatit 6 mujor, brenda të cilit ankesa duhet të paraqitet në Panel (rregulla 25(3) e rregullores së punës së Panelit). Vendimi i Panelit të Gjykatës së Qarkut për dënimin e ankuesit dhe mos llogaritja e kohës që ai e kishte kaluar në paraburgim para shpalljes fajtor dhe dënimit të tij ishte dhënë me 17 dhjetor 2012, ndërsa kjo ankesë ishte parashtruar në Panel me 28 korrik 2015.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën, pasi ajo bie jashtë juridiksionit të tij sipas nenit 29 (d) të rregullores së punës dhe nuk është në përputhje me nenin 25(3) të rregullores sa i përket afatin për paraqitjen e një ankese, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPANUESHME.

Për Panelin,

Joanna Marszalik
Zyrtare ligjore



Magda Mierzewska
Kryesuese